




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

DËGJIM BUXHETOR ME GRUPE TE GRAVE, STUDENTË DHE TË RINJTË, PENSIONISTË, PERSONA ME AFTËSI TË VEÇANTA DHE QYTETARË TJERË PËR KAB 2025 - 2027

Salla e Kuvendit Komunal Skenderaj
Më 07.06.2024, ora 13.00

Ekstrakt i procesverbalit

Drejtori për Buxhet dhe Financa, Ismet Aliu: Hapë takimin duke iu shprehur mirëseardhje pjesëmarrësve. Thekson rëndësinë e Kornizës Afatmesme Buxhetore, sqaron procesin e hartimit të buxhetit. Tregon se më 15 Maj e marrim Qarkoren e parë buxhetore të cilën jemi të obliguar ta miratojmë dhe të e përcjellim në Ministri. Pastaj, në Gusht vazhdojmë me dëgjimet buxhetore. Ia kalon fjalën kryetarit.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Përvendetje! Përmend rëndësinë e këtyre takimeve për dëgjimet buxhetore, konkretisht kërkesave të qytetarëve në prioritetizimin e projekteve. Në bazë të kërkesave të juaja ne vendosim për projektet, si: në infrastrukturë, subvencione, etj.

Kemi edhe dëgjime tjera me grupe të tjera të interesit, por ky është dëgjimi i parë, andaj faleminderit për pjesëmarrje dhe iu ftoj të i parashtroni kërkesat e juaja!

Drejtori për Buxhet dhe Financa, Ismet Aliu: sqaron rëndësinë e kërkesave të pjesëmarrësve në përcaktimin e prioriteteve për hartimin e buxhetit dhe fton pjesëmarrësit që ta marrin fjalën.

Valbona Ismajli Salihi: Unë vij nga fshati Syrikanë. Ne si fshat kemi nevoja të shumta. Ujësjellësin e kemi në gjëndje të rëndë sepse nuk mirëmbahet dhe duhet patjetër të investohet në të. Gjithashtu, kërkojmë investime në shëndetësi.

Edhe vitin e kaluar kam marrë pjesë në dëgjim buxhetor, ndërsa rrugët kryesore, grumbullimi i mbeturinave, elektriciteti janë në rregull.

Si shqetësim për fshatin tonë është rënia e numrit të banorëve, kemi nevojë për transport të fëmijëve për në shkollë, në Runik. Kërkoj përkrahje për fermerët dhe përkrahje të bizneseve të grave, si dhe kemi nevojë për transport publik, sepse vijat e transportit aktualisht janë shumë rrallë.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: falënderon Valbonën dhe fton pjesëmarrësit të e marrin fjalën.

Valbona ka të drejtë për ikjen e banorëve, ku me këtë ikje po përballen më shumë fshatrat e largëta. Por, ne si komunë jemi duke investu në mënyrë që të ndikojmë në ndaljen e qytetarëve në vendbanimet e tyre, e që në pjesën e juaj i kemi dhënë rëndësi turizmit dhe aktualisht jemi duke e kryer rrugën Syrikanë – Bjeshkët e Syrikanës.

Sa i përket ujësjellësit si Komunë në përgjithësi kemi nevojë pë rritjen e kapacitetit prej Mitrovice, ndërsa për pjesën e juaj gjendja e vjetruar duhet të mërëmbahet.

Shëndetësia ka qenë prioritet dhe kemi investu në ambulancën e Runikut dhe është funksionale.

Tek përkrahja e fermerëve nëpërmjet subvencioneve vazhdimisht po i përkrahim fermerët, por gjithashtu edhe bizneset dhe ndërmarrësit e rinj e sidomos gratë. Ju inkurajoj të aplikoni!

Transporti publik është çështje problematike sepse kompanitë private në ato zona ku nuk ka numër të madh të udhëtarëve, pra nuk kanë interes të i shtojnë vijat qarkulluese, ndërsa ne si komunë nuk mund t'i obligojmë.

Valbona Ismajli Salih: rrugët e lagjeve janë në gjëndje të keqe dhe duhet të asfaltohen dhe të punohet në trotuare.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: për trotuare përfshin e juaj kemi bërë kërkesë në Ministri për realizimin e projektit në mënyrë që të përfitojmë nga fondet për komunitete.

Valbona Ismajli Salih: punimi i kanalizimit po shkon ngadalë. Pse po ndodhë kjo?

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: kanalizimin po e kryjmë me fazë në bazë të mundësive financiare.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, Ismet Aliu: A ka të tjerë të intersuar për ta marrë fjalën? Atëherë meqenëse nuk ka të tjerë të interesuar faleminderit për pjesëmarrje dhe e myllim këtë takim.

Procesmbajtësi: Albert Rexhepi

